

SQ Lavatriçe

Udhëzimet për përdorim

PËRMBAJTJA

1. TË DHËNA PËR SIGURINË.....	3
2. UDHËZIMET PËR SIGURINË.....	5
3. PËRSHKRIM I PRODUKTIT.....	7
4. TË DHËNA TEKNIKE.....	8
5. INSTALIMI.....	8
6. PANELI I KONTROLLIT.....	11
7. ÇELËSI PËRZGJEDHËS DHE BUTONAT.....	12
8. PROGRAMET.....	14
9. CILËSIMET.....	19
10. PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË.....	19
11. PËRDORIMI I PËRDITSHËM.....	20
12. UDHËZIME DHE KËSHILLA.....	23
13. KUJDESI DHE PASTRIMI.....	25
14. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE.....	28
15. VLERAT E KONSUMIT.....	31
16. UDHËZUES I SHPEJTË.....	33
17. ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AMBIENTIN.....	34

NE MENDOJMË PËR JU

Faleminderit për blerjen e një pajisjeje Electrolux. Keni zgjedhur një produkt që sjell me vete dekada eksperience dhe novatorizmi profesional. Origjinal dhe me stil, është projektuar duke ju pasur ju në mendje. Kështu që sa herë që ta përdorni, mund të bazoheni në faktin se do të merrni rezultate optimale çdo herë. Mirë se vini në Electrolux.

Vizitoni faqen tonë të internetit për:



Të marrë këshilla mbi përdorimin, broshura, informacion rreth zgjidhjes së problemeve, shërbimit dhe riparimit

www.electrolux.com/support



Regjistrojeni produktin për shërbim më të mirë:

www.registerelectrolux.com



Blini aksesore, pjesë konsumi dhe pjesë origjinale këmbimi për pajisjen:

www.electrolux.com/shop

KUJDESI DHE SHËRBIMI NDAJ KLIENTIT

Përdorni gjithmonë pjesë këmbimi origjinale.

Kur kontaktoni Qendrën tonë të Autorizuar të Shërbimit, sigurohuni që të keni në dispozicion të dhënat e mëposhtme: Modeli, PNC, numri serial.

Ky Informacioni mund të gjendet në pllakën e klasifikimit.

 Paralajmërim / Të dhëna rreth sigurisë dhe kujdesit

 Të dhëna të përgjithshme dhe këshilla

 Të dhëna rreth ambientit

Rezervohet mundësia e ndryshimeve.

1. ⚠ TË DHËNA PËR SIGURINË



Përpara fillimit të instalimit dhe përdorimit të kësaj pajisje, lexoni me kujdes udhëzimet e dhëna. Prodhuesi nuk është përgjegjës për lëndimet apo dëmet si rezultat i instalimit apo përdorimit të papërshtatshëm. Gjithmonë mbajini udhëzimet në një vend të sigurt dhe ku mund të arrihen lehtë për t'iu referuar në të ardhmen.

1.1 Siguria e fëmijëve dhe personave vulnerabël

- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e sipër dhe persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijimesh ose mendore ose që nuk kanë eksperiencë dhe njohuri, nëse këta mbahen nën mbikëqyrje ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjes dhe i kuptojnë rreziqet e përdorimit.
- Fëmijët nga 3 deri në 8 vjeç dhe personat me aftësi të kufizuara shumë të theksuara dhe komplekse duhet të mbahen larg nga pajisja, përveçse kur mbahen nën monitorim të vazhdueshëm.
- Fëmijët më të vegjël se 3 vjeç duhet të mbahen larg nga pajisja, përveçse kur mbikëqyren në mënyrë të vazhdueshme.
- Fëmijët duhet të monitorohen për t'u siguruar se nuk luajnë me pajisjen.
- Mbajeni të gjithë paketimin larg nga fëmijët dhe hidheni atë siç kërkohet.
- Mbajini detergjentet larg fëmijëve.
- Mbajini fëmijët dhe kafshët shtëpiake larg pajisjes, gjatë kohës që dera e saj është e hapur.
- Nëse pajisja ka një mekanizëm për sigurinë e fëmijëve, ai duhet aktivizuar.
- Fëmijët nuk duhet të kryejnë pastrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes pa mbikëqyrje.

1.2 Siguria e përgjithshme

- Kjo pajisje është vetëm për larjen dhe tharjen e rrobave të llojit shtëpiak që lahen në lavatriçe.
- Kjo pajisje është krijuar për përdorim shtëpiak në ambient të brendshëm.
- Kjo pajisje mund të përdoret në: zyra, dhoma hoteli, dhoma bujtine, dhoma hoteli rural, si dhe në vende të ngjashme ku përdorimi nuk tejkalon (mesatarisht) nivelet e përdorimit shtëpiak.
- Mos i ndryshoni specifikimet e pajisjes.
- Ngarkesa maksimale e pajisjes është 6 kg. Mos tejkaloni ngarkesën maksimale të çdo programi (referojuni kapitullit "Programet").
- Presioni i punës i ujit në pikën e hyrjes së ujit nga lidhja e daljes duhet të jetë midis 0,5 bar (0,05 MPa) dhe 10 bar (1.0 MPa).
- Vrima e ajrimit në pjesën e poshtme nuk duhet të mbulohet nga tapeti, rrugica apo ndonjë mbulesë tjetër dysHEMEJE.
- Pajisja duhet të lidhet me furnizimin me ujë duke përdorur kompletin e ri të tubave që vjen me pajisjen ose komplete të tjera të reja tubash të ofruara nga qendra e autorizuar e shërbimit.
- Zorrat e vjetra nuk duhen ripërdorur.
- Për të shmangur rreziqet elektrike, nëse kabloja e energjisë elektrike është e dëmtuar, ajo duhet ndërruar nga prodhuesi, qendra e autorizuar e shërbimit ose persona me kualifikim të ngjashëm.
- Përpara se të kryeni shërbim mirëmbajtjeje, çaktivizoni pajisjen dhe hiqni spinën nga priza.
- Mos përdorni spërkatës me ujë me presion të lartë dhe/ose avull për të pastruar pajisjen.
- Pastrojeni pajisjen me copë të butë e të njomë. Përdorni vetëm detergjente neutrale. Mos përdorni produkte gërryese, materiale të ashpra pastruese, tretës ose objekte metalike.

2. UDHËZIMET PËR SIGURINË

2.1 Instalimi



Instalimi duhet të jetë në përputhje me rregulloret përkatës kombëtare.

- Hiqni të gjithë ambalazhin dhe bulonat e transportit duke përfshirë furçën prej gome dhe distancatorin plastik.
- Mbjajni bulonat e transportit në një vend të sigurt. Nëse pajisja do të transportohet në të ardhmen, ata duhet të vendosen për të bllokuar kazanin për të parandaluar dëmtimet e brendshme.
- Gjithmonë bëni kujdes kur e lëvizni pajisjen sepse është e rëndë. Përdorni gjithnjë doreza sigurie dhe këpucë të mbyllura.
- Ndiqni udhëzimet e instalimit të dhëna me pajisjen.
- Mos instaloni ose mos përdorni një pajisje të dëmtuar.
- Mos e instaloni ose mos e përdorni pajisjen kur temperatura mund të jetë më e ulët se 0°C ose kur ekspozohet ndaj kushteve atmosferike.
- Zona e dyshemesë ku do të instalohet pajisja duhet të jetë e sheshtë, e qëndrueshme, rezistente ndaj nxehtësisë dhe e pastër.
- Sigurohuni që ndërmjet pajisjes dhe dyshemesë të qarkullojë ajër.
- Pasi ta keni vendosur pajisjen në vendin e saj të përhershëm të punës, kontrolloni që të jetë saktësisht e niveluar me ndihmën e një niveluesi. Nëse jo, rregulloni këmbëzat siç duhet.
- Mos e instaloni pajisjen direkt mbi një piletë në dysheme.
- Mos spërkatni ujë mbi pajisje dhe mos e ekspozoni atë ndaj lagështirës së tepërt.
- Mos e instaloni pajisjen në një vend ku kapaku i pajisjes nuk mund të hapet plotësisht.
- Mos vendosni një enë të mbyllur për të grumbulluar ujin që mund të rrjedhë nën pajisje. Kontaktoni me Qendrën e Autorizuar të Shërbimit për t'u siguruar se cilët aksesore mund të përdoren.

2.2 Lidhja elektrike



PARALAJMËRIM!

Rrezik zjarri dhe goditjeje elektrike.

- **PARALAJMËRIM:** Kjo pajisje është krijuar për t'u instaluar / lidhur me një lidhje tokëzimi në ndërtesë.
- Përdorni gjithmonë një prizë të tokëzuar të instaluar si duhet.
- Sigurohuni që parametrat në pllakën e specifikimeve të përkojnë me vlerat elektrike të rrjetit elektrik.
- Mos përdorni përshtatës me shumë spina dhe kablo zgjatuese.
- Sigurohuni që të mos dëmtoni prizën dhe kabllon elektrike. Nëse kabloja elektrike duhet zëvendësuar, kjo duhet bërë nga Qendra jonë e autorizuar e shërbimit.
- Pajisjen futeni në prizë vetëm në fund të instalimit. Sigurohuni që spina të jetë e arritshme pas montimit të pajisjes.
- Mos e prekni kabllon elektrike ose spinën e rrymës me duar të lagura.
- Mos e shkëputni pajisjen nga rrjeti duke e tërhequr nga kabloja elektrike. Gjithmonë tërhiqeni kabllon elektrike duke e kapur nga spina.

2.3 Lidhja e shkarkimit të ujit

- Uji i hyrjes nuk duhet të kalojë 25 ° C.
- Mos u shkaktoni dëmtim tubave të ujit.
- Përpara lidhjes me tuba të rinj, tubat që nuk janë përdorur për një kohë të gjatë, aty ku janë kryer punime riparimi ose janë vendosur pajisje të reja (sahate uji, etj.), lëreni ujin të rrjedhë derisa të jetë i kthjellët dhe i pastër.
- Sigurohuni që të mos ketë rrjedhje të dukshme uji gjatë dhe pas përdorimit të parë të pajisjes.
- Mos përdorni zorrë zgjatuese nëse zorra e hyrjes së ujit është tepër e shkurtër. Kontaktoni me Qendrën e Autorizuar të Shërbimit për zëvendësimin e zorrëve të hyrjes së ujit.

- Gjatë shpaktimit të pajisjes, ka mundësi të shihni të derdhet ujë nga zorra e shkarkimit. Kjo ndodh për shkak të testimit të pajisjes me ujë në fabrikë.
- Ju mund ta zgjasni zorren e kullimit në maksimumi 400 cm. Kontaktoni Qendrën e Autorizuar të Shërbimit për zorren tjetër të kullimit dhe zgjatimin.
- Sigurohuni që rubineti të jetë i arritshëm pas montimit.

2.4 Përdorimi



PARALAJMËRIM!

Rrezik plagosjeje, goditjeje elektrike, zjarri, djegieje ose dëmtimi të pajisjes.

- Zbatoni udhëzimet e sigurisë në ambalazhin e detergjentit.
- Mos vendosni produkte që marrin flakë ose sende të lagura me produkte të ndezshme brenda, pranë pajisjes ose mbi të.
- Mos lani pëlhura që janë të ndotura shumë me vajra, graso apo substanca të tjera vajore. Kjo mund të dëmtojë pjesët prej gome të lavatriçes. Lajini paraprakisht këto pëlhura me dorë përpara se t'i ngarkoni në lavatriçe.
- Sigurohuni që të keni hequr të gjitha objektet metalike nga rrobat.

2.5 Shërbimi

- Për të riparuar pajisjen kontaktoni me qendrën e autorizuar të shërbimit. Përdorni vetëm pjesë rezervë origjinale.
- Ju lutemi vini re se vetëriparimi ose riparimi joprofesional mund të ketë pasojë sigurie dhe mund të zhvlerësojë garancinë.
- Pjesët e mëposhtme të këmbimit do të jenë të disponueshme për 10 vjet pas daljes nga qarkullimi të modelit: motori dhe karbonçinat e motorit, transmisioni mes motorit dhe kazanit, amortizatorët dhe sustat, kazani i

larjes, grupi i pasmë i kazanit dhe kushinetat përkatëse, ngrohësit dhe elementet e ngrohjes, duke përfshirë pompat e nxehtësisë, tubacionet dhe pajisjet përkatëse duke përfshirë zorrët, valvulat, filtrat dhe bllokuesit e ujit, qarqet elektrike, ekranet elektrike, çelësat e presionit, termostatat dhe sensorët, softuerët dhe firmuerët duke përfshirë softuerin e rivendosjes, derën, menteshën dhe guarnicionet e derës, guarnicionet e tjera, grupin e kyçjes së derës, mjetet periferike plastike si p.sh. foletë e detergjentit. Ju lutemi vini re se disa nga këto pjesë këmbimi janë të disponueshme vetëm për riparuesit profesionistë, dhe se jo të gjitha pjesët e këmbimit u përshtaten të gjitha modeleve.

- Në lidhje me llambat brenda produktit dhe llambat e pjesëve të këmbimit të shitura veçmas: Këto llamba janë prodhuar për kushte ekstreme fizike në pajisjet elektroshtëpiake, si p.sh. temperaturë, dridhje, lagështirë, ose janë prodhuar për të sinjalizuar informacion rreth statusit të përdorimit të pajisjes. Ato nuk janë prodhuar për t'u përdorur në aplikacione të tjera dhe nuk janë të përshtatshme për ndriçim në ambiente shtëpiake.

2.6 Eliminimi i pajisjes



PARALAJMËRIM!

Rrezik plagosjeje ose mbytjeje.

- Shkëputeni pajisjen nga rrjeti i furnizimit me energji dhe ai me ujë.
- Priteni kabllon e rrjetit elektrik pranë pajisjes dhe hidheni atë.
- Hiqni kapësen e derës për të parandaluar ngecjen e fëmijëve dhe të kafshëve shtëpiake brenda kazanit.
- Hidheni pajisjen në përputhje me kërkesat lokale për hedhjen e pajisjeve mbeturina elektrike dhe elektronike (WEEE).

3. PËRSHKRIM I PRODUKTIT


3.1 Veçoritë e veçanta

Lavatriçja juaj e re plotëson të gjitha kërkesat bashkëkohore për trajtimin efektiv të rrobave me konsum të vogël uji, energjie dhe detergjenti dhe do të kujdeset për pëlhurat.

- **SensiCare System** rregullon automatikisht kohëzgjatjen e

programit për rrobat në kazan për të arritur rezultatet më të mira në larje brenda kohës më të shkurtër të mundshme. Lexoni paragrafin "Zbulimi i ngarkesës SensiCare System" për më shumë detaje.

3.2 Pamje e përgjithshme e pajisjes



1 Paneli i kontrollit

2 Kapaku

3 Doreza e kapakut

4 Filtri i pompës së shkarkimit

5 Këmbët për nivelimin e pajisjes

6 Tubi i futjes së ujit

7 Tubi i shkarkimit

8 Kabloja e furnizimit me energji


9 Bulonat e transportit

10 Suporti i tubit


11 Etiketa e specifikimeve

Informacioni për regjistrimin e produktit.

Pllakëza e specifikimeve tregon emrin e modelit (A) , numrin e produktit (B), parametrat elektrikë (C) dhe numrin e serisë (D).



Etiketa e informacionit tregon emrin e modelit (A), numrin e produktit (B) dhe numrin e serisë (C).



4. TË DHËNA TEKNIKE

Përmasat	Gjerësia / Lartësia / Thellësia totale	39,7 cm /90,8 cm /59,9 cm
Lidhja elektrike	Tensioni Overall power Fuse Frekuenca	230 V 2200 W 10 A 50 Hz
Niveli i mbrojtjes kundër hyrjes së grimcave të ngurta dhe lagështisë i siguruar prej mbulesës mbrojtëse, përveç rasteve kur pajisjet e voltazhit të ulët nuk kanë mbrojtje nga lagështia		IPX4
Presioni i furnizimit me ujë	Minimal Maksimal	0.5 bar (0.05 MPa) 10 bar (1.0 MPa)
Furnizimi me ujë ¹⁾		Ujë i ftohtë
Ngarkesa maksimale	Të pambukta	6 kg
Shpejtësia e centrifugimit	Shpejtësia maksimale e centrifugimit	1151 rpm

1) Lidheni zorrën e hyrjes së ujit me një rubinet me 3/4" filetim.


5. INSTALIMI




PARALAJMËRIM!
Referojuni kapitujve për sigurinë.

5.1 Shpaketimi dhe pozicionimi


1.




2.



3.



4.



Rekomandojmë që të mbani të gjithë ambalazhin dhe bulonat e transportit për çdo rast kur ju duhet ta transportoni pajisjen.


Rregulloni pajisjen saktësisht për të parandaluar dridhjen, zhurmën dhe lëvizjen e pajisjes kur është në punë.



PARALAJMËRIM!

Mos vendosni karton, dru apo materiale të tjera poshtë këmbëzave të pajisjes për të rregulluar nivelin.


5.2 Zorra e furnizimit me ujë



Aksesorët që keni marrë bashkë me pajisjen mund të variojnë në varësi të modelit.

i Sigurohuni që zorrët të mos kenë dëmtime dhe që të mos ketë rrjedhje nga vendet e bashkimit. Mos përdorni zorrë zgjatuese nëse zorra e furnizimit me ujë është tepër e shkurtër. Kontaktoni me qendrën e shërbimit për zëvendësimin e zorrës së furnizimit të ujit.

5.3 Shkarkimi i ujit



Zorra e shkarkimit duhet të qëndrojë në një lartësi jo më të vogël se 600 mm dhe jo më të madhe se 1000 mm.

Ju mund ta zgjasni zorrën e shkarkimit maksimumi 4000 mm. Kontaktoni me qendrën e autorizuar të shërbimit për zorrë tjetër shkarkimi dhe për zgjatues.

5.4 Lidhja elektrike

Në fund të instalimit mund të futni në prizë spinën e pajisjes.


Pllakëza e specifikimeve dhe kapitulli "Të dhënat teknike" tregojnë parametrat e

nevojshëm elektrikë. Sigurohuni që të jenë në pajtim me furnizimin kryesor me energji.

Kontrolloni që instalimet elektrike të shtëpisë tuaj mund të durojnë ngarkesën maksimale e parashikuar, duke patur

parasysd edhe pajisje të tjera shtëpiake në përdorim

Lidhjeni pajisjen në një prizë me tokëzim.




Kabloja e lidhjes me rrjetin duhet të jetë lehtësisht e arritshme pas instalimit të pajisjes.

Për punimet elektrike që nevojiten për instalimin e kësaj pajisjeje, kontaktoni me Qendrën tonë të Autorizuar të Shërbimit.

Prodhuesi nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmtime ose lëndime të shkaktuara si pasojë e mosndjekjes së udhëzimeve të mësipërme të sigurisë.

6. PANELI I KONTROLLIT

6.1 Përshkrimi i panelit të kontrollit



- 1** Çelësi i programeve
- 2** Ekрани
- 3** Kursimi i kohës butoni me prekje
- 4** Vonesë në nisje butoni me prekje
- 5** Start/Pause butoni me prekje
- 6** Paralarje butoni me prekje
- 7** Spin butoni me prekje i opsioneve të reduktimit

- 8** Temperatura butoni me prekje
- 9** Ndezje/Fikje butoni me shtypje
- 10** Treguesit:
 - Shpëlarje shtesë
 - Natë
 - Ndërprerje e shpëlarjes

6.2 Ekran

	A Treguesi i kapakut të bllokuar.
	B Treguesi i bllokimit të sigurisë për fëmijët.
	C 18.8°C Treguesi dixhital mund të tregojë: • Kohëzgjatja e programit (p.sh. 2:40). • Koha e vonesës (p.sh. 2h). • Përfundimi i ciklit (000). • Kodi i paralajmërimit (p.sh. E20). • Temperatura (88°). • Shpejtësia e centrifugimit (1888, treguesi Pa centrifugim - - -).

7. ÇELËSI PËRZGJEDHËS DHE BUTONAT

7.1 Hyrje



Opsionet/funksionet nuk janë të disponueshme për gjithë programet e larjes. Kontrolloni përputhshmërinë midis opsioneve/funksioneve dhe programeve të larjes në "Tabelën e programeve". Një opsion/funksion mund të përjashtojë një tjetër, në këtë rast pajisja nuk ju lejon të vendosni opsione/funksione të papajtueshme.

7.2 Kursimi i kohës ⌚

Ky opsion mund të këshillohet për të shkurtuar programin e larjes.

Përdorni këtë opsion për artikuj me ndotje normale ose të ndotur pak ose për t'i freskuar.

Prekni këtë buton **një herë** për të ulur kohëzgjatjen.

Në rast ngarkese më të vogël, prekni këtë buton **dy herë** për të vendosur një program shtesë të shpejtë.

Pas secilës prekje, shfaqet në ekran koha e re e programit. Treguesi përkatës ndriçon. Ky opsion nuk është i disponueshëm me çdo program. Për më shumë detaje, referojuni pajtueshmërisë së opsioneve të Programit të kapitulli "Programet".

7.3 Vonesë në nisje ⌚

Me këtë opsion mund ta shtyni fillimin e programit deri në një kohë më të të volitshme.

Prekni në mënyrë të përsëritur butonin për të vendosur shtyrjen e kërkuar. Koha rritet me hapa prej 1 ore deri në 20 orësh.

Pas prekjes së butonit Start/Pause ▷||, treguesi përkatës ndiizet dhe koha e vonesës dhe pajisja fillon numërimin mbrapsht. Kapaku është i bllokuar.

7.4 Start/Pause ▷||

Shtypni butonin Start/Pause ▷|| për të filluar, vendosur në pauzë ose ndërprerë një program që është në punë.

7.5 Paralarje

Me këtë opsion mund të shtoni një fazë paralarjeje të një program larjeje.

Treguesi përkatës ndriçon.

- Përdoren këto funksion për të shtuar një fazë paralarjeje në 30 °C përpara fazës së larjes.
Ky opsion rekomandohet për rrobat e ndotura shumë, veçanërisht nëse përmbajnë rërë, pluhur, baltë dhe grimca të tjera të ngurta.



Ky opsion mund të rrisë pak kohëzgjatjen e programit.

7.6 Centrifugimi

Kur vendosni një program, pajisja vendos automatikisht shpejtësinë maksimale të lejuar të centrifugimit, përveç programit Denim.

Shtypni këtë buton për të caktuar opsione shtesë centrifugimi:

- **Ulni shpejtësinë e centrifugimit.** Ekрани tregon vetëm shpejtësitë e disponueshme të centrifugimit për programin e vendosur.
- **Në ekran shfaqet Pa centrifugim**

— — —

Vendosni këtë opsion për të çaktivizuar të gjitha fazat e centrifugimit. Pajisja kryen vetëm fazën e shkarkimit të programit të zgjedhur të larjes. Vendosni këtë opsion për pëlhura shumë delikate. Faza e shpëlarjes përdor më shumë ujë për disa programe larjeje

- **Ndërprerje e shpëlarjes .**
Treguesi përkatës ndizet.
Nuk është kryer centrifugimi i fundit.
Uji i shpëlarjes së fundit nuk do të shkarkohet për të evituar zhubrosjen e rrobave. Programi i larjes përfundon me ujë në kazan.
Kapaku qëndron i kyçur dhe kazani rrotullohet rregullisht për të reduktuar rrudhosjen. Për të hapur kapakun duhet të shkarkoni ujin.

Nëse prekni butonin Start/Pause , pajisja kryen një fazë centrifugimi dhe shkarkon ujin.

- **Natë .** Treguesi përkatës ndizet.
Të gjitha fazat e centrifugimit të ndërmjetme dhe përfundimtare anulohen dhe programi përfundon me ujë në kazan. Kjo ndihmon për të reduktuar rrudhosjen. Kapaku qëndron i bllokuar. Kazani rrotullohet rregullisht për të reduktuar rrudhosjen. Për të hapur kapakun duhet të shkarkoni ujin.
Duke qenë se programi është shumë i heshtur, është i përshtatshëm për t'u përdorur gjatë natës kur disponohen edhe tarifa më të lira për energjinë elektrike. Në disa programe, shpëlarjet kryhen me më shumë ujë.
Nëse prekni butonin Start/Pause , pajisja kryen vetëm fazën e shkarkimit.



Pajisja e zbraz ujin automatikisht pas afro 18 orësh.

7.7 Temperatura

Kur përzgjidhni një program larjeje, pajisja propozon automatikisht një temperaturë të parazgjedhur.

Prekni këtë buton në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet vlera e dëshiruar e temperaturës në ekran.

Kur ekrani shfaq treguesit _ _ °, pajisja nuk e ngroh ujin.

7.8 Ndezje/Fikje

Shtypni këtë buton për pak sekonda për të aktivizuar ose çaktivizuar pajisjen. Dëgjohen dy tinguj të ndryshëm gjatë ndezjes ose fikjes së pajisjes.

Ndërsa funksion i Pritjes aktive e çaktivizon automatikisht pajisjen pas disa minutash për të ulur konsumin e energjisë, mund t'ju nevojitet ta aktivizoni sërish pajisjen.

Për më shumë detaje, referojuni paragrafit "Pritja aktive" në kapitullin "Përdorimi i përditshëm".

8. PROGRAMET

8.1 Skema e programeve

Programi Temperatura e parazgjedhur Diapazoni i temperaturës	Shpejtësi a referencë e centrifugimi mit Gama e shpejtësis ë së centrifugimi mit [rpm]	Ngark esa maksi male	Përshkrimi i programit (Lloji i ngarkesës dhe niveli i ndotjes)
Eco 40-60 40°C ¹⁾	1200 rpm (1200- 400)	6 kg	Të pambuktat e bardha dhe me ngjyra të shpejta. Artikuj të ndotur normalisht. Konsumi i energjisë ulet dhe koha e programit të larjes zgjatet, duke siguruar rezultate të mira në larje.
Cottons 40°C 90°C - Ftohtë	1200 rpm (1200- 400)	6 kg	Të pambuktat e bardha dhe me ngjyra. Ndotje normale dhe e madhe.
Synthetics 40°C 60 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200 - 400)	3 kg	Artikuj sintetikë ose tekstile të përziera. Artikuj të ndotur normalisht.
Delicates 30°C 40 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200- 400)	2 kg	Tekstile delikate të tilla si akrilike, viskoze dhe tekstile të përziera kërkojnë larje më delikate. Artikuj me ndotje normale dhe të lehtë.
Rapid 14min 30°C	800 rpm (800- 400)	1,5 kg	Tekstile sintetike dhe të përziera. Artikuj të ndotur pak dhe artikuj për të rifreskuar.
Rinse	1200 rpm (1200- 400)	6 kg	Të gjitha tekstilet, përveç të leshtave dhe tekstileve shumë delikate. Program për të shpëlarë dhe për të centrifuguar rrobat. Shpejtësia e parazgjedhur e centrifugimit është ajo që përdoret për programet e pambukut. Reduktojeni shpejtësinë e centrifugimit sipas llojit të rrobave. Nëse është e nevojshme, caktoni Shpëlarje shtesë opsionin për të shtuar shpëlarje. Me një shpejtësi të ulët centrifugimi, pajisja kryen shpëlarje delikate dhe centrifugim të shkurtër.
Spin/Drain	1200 rpm (1200 -400)	6 kg	Të gjitha tekstilet, përveç të leshtave dhe tekstileve delikate. Për të centrifuguar rrobat dhe për të shkarkuar ujin e kazanit.

Programi Temperatura e parazgjedhur Diapazoni i temperaturës	Shpejtësi a referencë e centrifugi mit Gama e shpejtësis ë së centrifugi mit [rpm]	Ngark esa maks male	Përshkrimi i programit (Lloji i ngarkesës dhe niveli i ndotjes)
Anti-allergy  60°C	1200 rpm (1200 - 400)	6 kg	Artikuj të bardhë të pambuktë. Ky program largon mikro-organizmat falë një faze larjeje me temperaturë që mbahet mbi 60°C për disa minuta. Kjo ndihmon në heqjen e mikrobeve, baktereve, mikroorganizmave dhe grimcave. Shtesa e avullit së bashku me një fazë shtesë shpëlarjeje siguron heqjen e mirë të mbetjeve të detergjentit dhe polenit/substancave alergjike, duke e bërë të përshtatshme për lëkura delikate dhe të ndjeshme.
Baby 40°C 40 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200 - 400)	2 kg	Cikël delikat i përshtatshëm për rrobat e bebeve. Niveli i lartë i ujit dhe lëvizja delikate në fazën e larjes mbron ngjyrat dhe fibrat.
Silk  30°C	800 rpm (800 - 400)	0,5 kg	Program special për rroba mëndafshi dhe sintetike të përziera.
Wool  40°C 40 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200- 400)	1 kg	Të leshta që lahen në makinë larëse, të leshta që lahen me dorë dhe tekstile të tjera me simbolin e kujdesit "larje me dorë"²⁾.
Sport 30°C 40 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200 - 400)	3 kg	Veshje sportive me tekstile të përziera. Artikuj me ndotje të lehtë ose artikuj për freskim.

Programi Temperatura e parazgjedhur Diapazoni i temperaturës	Shpejtësi a referencë e centrifugimi mit Gama e shpejtësisë së centrifugimi mit [rpm]	Ngarkesa maksimale	Përshkrimi i programit (Lloji i ngarkesës dhe niveli i ndotjes)
Outdoor  30°C 40 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200-400)	2 kg ³⁾ 1 kg ⁴⁾	 Mos përdorni zbutës rrobash dhe sigurohuni që kenë mbetur mbetje zbutësi në folenë e detergjentit. Artikuj sportivë sintetikë. Ky program është projektuar për të larë butësisht rrobat moderne sportive që përdoren jashtë dhe është gjithashtu i përshtatshëm për rrobat e palestrës, ciklizmit apo vrapimit ose artikuj të ngjashëm. Ngarkesa e rekomanduar për rrobat është 2 kg. Tekstile të papërshkueshme nga uji dhe të papërshkueshme nga uji që e lejojnë shkëmbimin e ajrit. Ky program mund të përdoret gjithashtu si cikël për rikthimin e papërshkueshmërisë së ujit, projektuar veçanërisht për trajtimin e rrobave me shtresë hidrofobike. Për të kryer ciklin e rikthimit të papërshkueshmërisë së ujit, veproni si vijon: • Derdhni detergjentin e larjes në ndarjen . • Derdhni një restaurues special papërshkueshmërie nga uji për pëlhura në folenë e zbutësit të rrobave të sirtarit . • Pakësoni ngarkesën e rrobave në 1 kg.  Për të përmirësuar më tej veprimin e restaurimit të papërshkueshmërisë së ujit, thajini rrobat në një tharëse rrobash duke vendosur programin e tharjes Outdoor (nëse disponohet dhe nëse etiketa e rrobave lejon tharjen në tharëse rrobash).

Programi Temperatura e parazgjedhur Diapazoni i temperaturës	Shpejtësi a referencë e centrifugi mit Gama e shpejtësis ë së centrifugi mit [rpm]	Ngark esa maks male	Përshkrimi i programit (Lloji i ngarkesës dhe niveli i ndotjes)
Denim 30 °C 40 °C - I ftohtë	800 rpm (1200 - 400)	2 kg	Program special për xhinse me fazë delikate larjeje për të minimizuar zbehjen e ngjyrave dhe shenjat. Për kujdes më të mirë, rekomandohet një ngarkesë e reduktuar.

1) Sipas Rregullores 2019/2023 të Komisionit të BE-së, ky program në 40 °C mund të pastrojë rrobat me ndotje normale të deklaruar se mund të lahen në 40 °C ose 60 °C, së bashku në të njëjtin cikël.



Për temperaturën e arritur në roba, kohëzgjatjen e programit dhe të dhënat e tjera, ju lutemi shikoni kapitullin "Vlerat e konsumimit".

Programet më efikase në lidhje me konsumin e energjisë janë në përgjithësi ato që performojnë në temperatura më të ulëta dhe kohëzgjatje më të gjata.

2) Gjatë këtij cikli kazani rrotullohet ngadalë për të garantuar larje delikate. Mund të duket që kazani nuk rrotullohet fare ose nuk rrotullohet mirë, por është normale për këtë program.

3) Programi i larjes.

4) Programi i larjes dhe faza e kthimit të papërshkueshmërisë nga uji.

Pajtueshmëria e opsioneve të programit

Programi	OPSIONET							
Eco 40-60		■	■	■		■	■	■
Cottons		■	■	■	■	■	■	■
Synthetics		■	■	■	■	■	■	■
Delicates		■	■	■	■	■		■
Rapid 14min		■	■	■				■
Rinse		■	■	■	■			■
Spin/Drain		■	■					■
Anti-allergy		■	■	■		■	■	■

Programi	OPSIONET	       								
										
Baby		■	■	■	■	■	■	■		
Silk 		■	■						■	
Wool  		■	■	■					■	
Sport		■	■	■		■	■	■		
Outdoor 		■	■	■		■			■	
Denim		■	■	■	■	■		■		

Detergjentët e përshtatshëm për programet e largjes

Programi	Pluhur universal ¹⁾	Lëng universal	Lëng për rroba me ngjyra	Delikate të leshta	Special
Eco 40-60	▲	▲	▲	--	--
Cottons	▲	▲	▲	--	--
Synthetics	▲	▲	▲	--	--
Delicates	--	--	--	▲	▲
Rapid 14min	--	▲	▲	--	--
Anti-allergy	▲	▲	--	--	▲
Baby	--	▲	▲	--	▲
Silk	--	--	--	▲	▲
Wool	--	--	--	▲	▲
Sport	--	▲	▲	--	▲
Outdoor	--	--	--	▲	▲
Denim	--	--	▲	▲	▲

¹⁾ Në temperaturë më të lartë se 60 °C rekomandohet përdorimi i detergjentit pluhur.

▲ = Rekomandohet

-- = Nuk rekomandohet

8.2 Woolmark Wool Care - Blu



Cikli i larjes për të leshtat në këtë lavatriçe është miratuar nga The Woolmark Company për larjen e rrobave të leshta që mbajnë etiketën «larje me dorë» që jepet që rrobat të lahen sipas udhëzimeve në etiketën e rrobës dhe ato të dhëna nga prodhuesi i kësaj lavatriçeje. M1145 Simboli "Woolmark" është markë certifikimi në shumë vende.

9. CILËSIMET

9.1 Sinjalet akustike

Kjo pajisje ka sinjale të ndryshme akustike, që veprojnë kur:

- Aktivizoni pajisjen (sinjal i shkurtër i veçantë).
- Çaktivizoni pajisjen (sinjal i shkurtër i veçantë).
- Prekni butonat (tingull klikimi).
- Bëni përzgjedhjen e gabuar (3 tinguj të shkurtër).
- Programi përfundon (sekuencë tingujsh për rreth 2 minuta).
- Programi ka keqfunksionim (sekuencë tingujsh të shkurtër për rreth 5 minuta).

Për të **aktivizuar/çaktivizuar** sinjalet akustike kur përfundon programi, prekni njëkohësisht butonat  dhe  për rreth 2 sekonda. Ekran tregon On/Off



Nëse çaktivizoni sinjalet akustike, ato vazhdojnë të punojnë kur pajisja ka keqfunksionim.

9.2 Bllokimi për fëmijët

Me këtë opsjon mund të parandaloni që fëmijët të luajnë me panelin e kontrollit.

Për të **aktivizuar/çaktivizuar** këtë

opsion, mbani shtypur butonin  derisa

 të **ndizet/fiket** në ekran.

Pajisja do të kalojë si parazgjedhje te ky opsjon pasi e fikni.

Funksioni i bllokimit për fëmijët mund të mos jetë i disponueshëm për pak sekonda pas ndezjes së pajisjes.

9.3 I përherëshëm Shpëlarje shtesë

Me këtë funksion mund të keni në mënyrë të përhershme një shpëlarje shtesë kur vendosni një program të ri.

- Për ta **aktivizuar/çaktivizuar** këtë opsjon, mbani shtypur butonin  derisa treguesi përkatës  të **ndizet/fiket**.

10. PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË

1. Sigurohuni që të disponohet energjia elektrike dhe që rubineti i ujit të jetë i hapur.
2. Derdhni 2 litra ujë në folenë e detergjentit të shënuar me .

Ky veprim aktivizon sistemin e shkarkimit.

3. Derdhni një sasi të vogël detergjenti në folenë e detergjentit të shënuar me .

4. Vendosni dhe startoni një program për të pambuktat në temperaturën më të lartë pa roba në kazan.

Kjo do të heqë të gjitha papastërtitë e mundshme nga tamburi dhe kazan.

11. PËRDORIMI I PËRDITSHËM



PARALAJMËRIM!

Referojuni kapitujve për sigurinë.


11.1 Aktivizimi i pajisjes

1. Futeni spinën në prizën elektrike.
2. Hapeni rubinetin e ujit.
3. Shtypni butonin Ndezje/Fikje për të aktivizuar pajisjen.

Bie një tingull i shkurtër.

11.2 Futja e rrobave në pajisje

1. Hapni kapakun e pajisjes.
2. Shtypni butonin **A**.



Kazani hapet automatikisht.

3. Vendosini artikujt në kazan, njërin pas tjetrit.
4. Shkundini artikujt përpara se t'i vendosni ato brenda pajisjes.

Sigurohuni që të mos fusni në kazan më shumë roba sesa duhet.

5. Mbyllni kazanin dhe kapakun.



KUJDES!

Përpara se të mbyllni kapakun e pajisjes, sigurohuni që ta keni mbyllur mirë kazanin.

11.3 Ndarjet e detergjentit.

Përdorimi i detergjenteve dhe i solucioneve


1. Matni sasinë e specifikuar të detergjenteve dhe të zbutësit të rrobave.
2. Vendosni detergjentin dhe zbutësin e rrobave te ndarjet e duhura.



Gjithmonë zbatoni udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produkteve të detergjentit, por rekomandojmë që të mos tejkaloni nivelin maksimal të treguar. Kjo sasi garanton rezultatet më të mira në larje.



Kur përdorni detergjente të lëngshme shtojini brenda një topi dozimi (që vjen nga prodhuesi i detergjentit). Futeni topin e dozimit brenda kazanit të lavatriçes, mbi roba.



Ndarja e detergjentit për fazën e paralarjes.



Ndarja e detergjentit për fazën e larjes.



Kutia për aditivët e lëngët (zbutës rrobash, niseshte).

Shenja **M** është niveli maksimal për sasinë e aditivëve të lëngët.

11.4 Vendosja e një programi

1. Rrotulloni çelësin e programeve për të zgjedhur programin e dëshiruar të larjes.

Treguesi i butonit Start/Pause pulson.

Ekrani tregon kohëzgjatjen e përafërt të programit.

2. Prekni butonat përkatës për të ndryshuar temperaturën dhe/ose shpejtësinë e centrifugimit.
3. Nëse dëshironi, vendosni një ose më shumë opsione duke prekur butonat përkatës.



Nëse **nuk është e mundur** përzgjedhja, bie një sinjal akustik.

11.5 Nisja e një programi

Prekni butonin Start/Pause për të nisur programin. Programi nuk mund të nisët kur treguesi i butonit është i çaktivizuar dhe nuk pulson (p.sh. çelësi i programeve në pozicion të gabuar).

Treguesi përkatës ndalon së pulsuar dhe qëndron i ndezur.

Programi fillon, kapaku është i bllokuar.

Ekrani shfaq treguesin .



Pompa e shkarkimit mund të punojë pak përpara se pajisja të mbushet me ujë.

11.6 Nisja e një programi me shtyrjen e programit

1. Prekni butonin Vonesë në nisje derisa ekrani të shfaqë kohën e dëshiruar të vonesës. Treguesi përkatës ndizet.

2. Prekni butonin Start/Pause . Kapaku i pajisjes kyçet dhe fillon numërimin mbrapsht të shtyrjes së programit. Ekrani shfaq treguesin . Kur përfundon numërimi mbrapsht, programi fillon automatikisht.

Anulimi i shtyrjes së programit pasi ka nisur numërimi mbrapsht

Për të anuluar shtyrjen e programit:

1. Prekni butonin Start/Pause për të vendosur pajisjen në pauzë. Pulson treguesi përkatës.
2. Prekni butonin Vonesë në nisje në mënyrë të përsëritur derisa ekrani të shfaqë .
3. Prekni sërish butonin Start/Pause për të nisur menjëherë programin.

Ndryshimi i shtyrjes së programit pasi ka nisur numërimi mbrapsht

Për të ndryshuar shtyrjen e programit:

1. Prekni butonin Start/Pause për të vendosur pajisjen në pauzë. Pulson treguesi përkatës.
2. Prekni butonin Vonesë në nisje në mënyrë të përsëritur derisa ekrani të shfaqë kohën e dëshiruar të vonesës.
3. Prekni sërish butonin Start/Pause për të nisur një numërim të ri mbrapsht.

11.7 Dallimi i ngarkesës me SensiCare System

Pas prejjes së butonit Start/Pause .

1. SensiCare System nis llogaritjen e peshës së ngarkesës për të llogaritur kohëzgjatjen reale të programit. Gjatë kësaj faze pulsojnë dy pikat që ndajnë orët nga minutat.
2. Pas rreth 15-20 minutash shfaqet kohëzgjatja e re e ciklit. Pajisja rregullon automatikisht kohëzgjatjen e programit për rrobash për të arritur rezultatet më të mira në

larje brenda kohës më të shkurtër të mundshme.



SensiCare System nuk është në dispozicion me të gjitha programet si p.sh. : Wool dhe programe me cikle të shkurtër.

11.8 Ndërprerja e programit dhe ndryshimi i opsioneve

Kur programi është në punë, mund të ndryshoni **vetëm disa** opsione:

1. Prekni butonin Start/Pause . Treguesi përkatës pulson.
2. Ndrysho opsionet. Informacioni i dhënë në ekran ndryshon përkatësisht.
3. Prekni sërish butonin Start/Pause .

Programi i larjes vazhdon.

11.9 Anulimi i një programi në punë

1. Shtypni butonin Ndezje/Fikje për të anuluar programin dhe për të çaktivizuar pajisjen.
2. Shtypni përsëri butonin Ndezje/Fikje për të aktivizuar pajisjen.



Nëse SensiCare System ka përfunduar dhe mbushja me ujë ka filluar tashmë, programi i ri fillon **pa përsëritur SensiCare System**. Uji dhe detergjenti nuk shkarkohen për të shmangur shpërdorimin.

Ekziston edhe një mënyrë alternative për anulimin:

1. Rrotullojeni çelësin përzgjedhës në pozicionin "Reset" (Rivendos) .
2. Pritni për 1 sekondë. Ekran tregon ---.

Tani mund të vendosni një program të ri larjeje.

11.10 Përfundimi i programit

Kur programi të ketë përfunduar, pajisja fiket automatikisht. Sinjalet akustike

funksionojnë, (nëse janë aktive). Ekran shfaq .

Treguesi i butonit Start/Pause  fiket.

Kapaku zhblokohet dhe treguesi  fiket.

1. Shtypni butonin e Ndezje/Fikje për të çaktivizuar pajisjen.

Pesë minuta pas përfundimit të programit, funksioni i kursimit të energjisë e çaktivizon automatikisht pajisjen.



Kur e aktivizoni pajisjen përsëri, ekran tregon fundin e programit të mëparshëm. Rrotullojeni çelësin e programeve për të vendosur një cikël të ri.

2. Nxirrni nga pajisja rrobat.
3. Sigurohuni që kazani të jetë bosh.
4. Mbajeni kapakun dhe folenë e detergjentit paksa të hapur, për të parandaluar mykun dhe erërat e pakëndshme.
5. Mbyllni rubinetin e ujit.

11.11 Shkarkimi i ujit jashtë pas mbarimit të ciklit

Nëse keni zgjedhur një program ose një opcion që nuk e zbraz ujin e shpëlarjes së fundit, programi përfundon, por:

- Zona e kohës shfaq  dhe ekran shfaq kapakun e kyçur .
- Kazani vazhdon të rrotullohet me intervale të rregullta për të parandaluar rrudhat te rrobat.
- Kapaku qëndron i bllokuar.
- Duhet të zbrazni ujin për të hapur kapakun:

1. Nëse është e nevojshme, prekni butonin Centrifugimi  për të ulur shpejtësinë e centrifugimit të propozuar nga pajisja.
2. Shtypni butonin Start/Pause :
 - Nëse keni vendosur Ndërprerje e shpëlarjes  pajisja shkarkon ujin dhe kryen centrifugimin.
 - Nëse keni vendosur Nata  pajisja vetëm shkarkon ujin

Zhduket treguesi i opsionit Ndërprerje e shpëlarjes  dhe Nata .

3. Kur programi mbaron dhe treguesi

 i bllokimit të kapakut fiket, ju mund ta hapni kapakun.

4. Shtypni butonin Ndezje/Fikje për pak sekonda për të çaktivizuar pajisjen.

11.12 Opsioni i Pritjes aktive

Funksioni i gatishmërisë çaktivizon automatikisht pajisjen për të ulur konsumimin e energjisë kur:

- Nuk e përdorni pajisjen për 5 minuta kur nuk ka program në punë. Shtypni butonin Ndezje/Fikje për ta aktivizuar pajisjen sërish.

- 5 minuta pas përfundimit të programit të larjes.

Shtypni butonin Ndezje/Fikje për ta aktivizuar pajisjen sërish.

Ekrani tregon përfundimin e programit të fundit.

Rrotullojeni çelësin e programeve për të vendosur një cikël të ri.

Nëse çelësi rrotullohet në pozicionin

"Reset" (Rivendosja) , pajisja fiket automatikisht pas 30 sekondash.



Nëse vendosni një program ose opcion që përfundon me ujë në kazan, funksioni i gatishmërisë **nuk çaktivizon** pajisjen për t'ju kujtuar të shkarkoni ujin.

12. UDHËZIME DHE KËSHILLA



PARALAJMËRIM!

Referojuni kapitujve për sigurinë.


12.1 Ngarkesa e rrobave

- Ndajini rrobat në: të bardha, me ngjyra, sintetike, delikate dhe të leshta.
- Zbatoni udhëzimet e larjes në etiketat e kujdesit të rrobat.
- Mos lani së bashku rrobat e bardha dhe ato me ngjyrë.
- Disa rroba me ngjyra mund të zbehen gjatë larjes së parë. Rekomandojmë që t'i lani ato veçmas dy-tri herët e para.
- Kthejini së prapthi rrobat me disa shtresa, të leshtat dhe veshjet me stampa.
- Trajtoni paraprakisht njollat e vështira.
- Lajini njollat e vështira me detergjent të veçantë.
- Bëni kujdes me perdet. Hiqini kapëset e tyre dhe futini perdet në një qese për larje apo këllëf jastëku.
- Një ngarkesë shumë e vogël mund të shkaktojë probleme balancimi gjatë fazës së centrifugimit duke çuar në dridhje të tepërta. Nëse ndodh kjo:
 - ndërprisni programin dhe hapni derën (referojuni kapitullit "Përdorimi i përditshëm");


b. rishpërndajeni me dorë ngarkesën në mënyrë që rrobat të shpërndahen njëtrajtësisht nëpër kazan;

c. shtypni butonin Start/Pause. Faza e centrifugimit vazhdon.

- Kopsitni këllëfët e jastëkëve, mbyllni zinxhirët, tokëzat dhe sustat. Lidhni rripat, kordonët, lidhëset e këpucëve, fjongot dhe çdo element tjetër të lirshëm.
- Mos lani rroba pa tegela ose me prerje. Përdorni një trastë larjeje për të larë rroba të vogla dhe/ose delikate (p.sh. sytjena me tela, rripa, streçe, lidhëse këpucësh, fjongo etj.).



- Zbrazeni xhepat dhe shpalosni rrobat.



12.2 Njollat e vështira

Për disa njolla, nuk mjafton uji dhe detergjenti.

Rekomandojmë që këto njolla t'i trajtoni përpara se të vendosni rrobat në pajisje.

Për këtë ka heqës të veçantë njollash. Përdorni heqës të veçantë njollash që i përshtaten llojit të njollës dhe pëlhurës.

12.3 Lloji dhe sasia e detergjentit

Zgjedhja e detergjentit dhe përdorimi i sasive të duhura jo vetëm që ndikon te performanca në larje, por ndihmon gjithashtu edhe në shmangien e mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit:

- Përdorni vetëm detergjente dhe trajtime të tjera të prodhuara posaçërisht për lavatriçe. Së pari, ndiqni këto rregulla të përgjithshme:
 - detergjentet në trajtë pluhuri për të gjitha llojet e rrobave, duke përfshirë delikatet. Preferohen detergjente pluhur që përmbajnë zbardhues për higjienizimin e të bardhave dhe rrobave të palara,
 - detergjentet në trajtë lëngu, mundësisht për programe me temperatura të ulëta (60 °C maksimumi) për të gjitha llojet e rrobave ose të posaçme vetëm për të leshtat.
- Zgjedhja dhe sasia e detergjentit varen nga: lloji i tekstilit (delikate, të leshta, pambuk etj.), ngjyra e rrobave, madhësia e ngarkesës, niveli i ndotjes, temperatura e larjes dhe fortësia e ujit të përdorur.
- Ndiqni udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i detergjenteve ose trajtimeve të tjera pa tejkalluar nivelin e treguar maksimal (**MAX**).

- Mos i përzieni llojet e ndryshme të detergjenteve.
- Përdorni më pak detergjent, nëse:
 - po lani një sasi të vogël rrobash,
 - rrobat nuk janë shumë të ndotura,
 - formohet shumë shkumë gjatë larjes.
- Kur përdorni tableta ose bustina detergjenti, gjithmonë futini brenda në kazan, jo në folenë e detergjentit.

Detergjenti i pamjaftueshëm mund të shkaktojë:

- rezultate të pakënaqshme larjeje,
- ngarkesa e larjes bëhet gri,
- rroba me yndyrë,
- myk në pajisje.

Detergjenti i tepërt mund të shkaktojë:

- prodhim të tepërt shkume,
- efekt larjeje të reduktuar,
- shpëlarje të pamjaftueshme,
- ndikim më të madh në mjedis.

12.4 Këshilla ekologjike

Për të kursyer ujin, energjinë, si dhe për të ndihmuar në mbrojtjen e mjedisit, rekomandojmë të ndiqni këto këshilla:

- **Rrobat me ndotje normale** mund të lahen **pa paralarje** për të kursyer detergjent, ujë dhe kohë (duke mbrojtur gjithashtu dhe mjedisin!).
- Mbushja e pajisjes deri në **kapacitetin maksimal që tregohet për secilin prej programeve, ndihmon në reduktimin e energjisë dhe konsumit të ujit**.
- Me trajtim të përshtatshëm paraprak, mund të hiqen njollat dhe ndotja deri në një farë shkalle; rrobat pastaj mund të lahen në temperaturë më të ulët.
- Për të përdorur sasinë e duhur të detergjentit, shikoni sasinë e sugjeruar nga prodhuesi i detergjentit dhe kontrolloni fortësinë e ujit të sistemit tuaj shtëpiak. Shikoni paragrafin "Fortësia e ujit".
- Caktimi **shpejtësinë maksimale të mundshme të centrifugimit** për programet e zgjedhura të larjes **përpara se të thani rrobat në tharëse**. Kjo do të kursejë energji gjatë tharjes!

12.5 Fortësia e ujit

Nëse fortësia e ujit në zonën tuaj është e lartë ose mesatare, rekomandojmë që të përdorni zbutës uji për lavatriçe. Në zonat ku uji është i butë nuk nevojitet përdorimi i zbutësit të ujit.

Kontaktoni me autoritetet lokale të ujësjellësit për të mësuar fortësinë e ujit.

Përdorni sasinë e duhur të zbutësit të ujit. Zbatoni udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produktit.

13. KUJDESI DHE PASTRIMI



PARALAJMËRIM!

Referojuni kapitujve për sigurinë.



Lexoni me kujdes kapitullin për mirëmbajtjen dhe kujdesin më të mirë.

13.1 Programi i pastrimit periodik

Pastrimi periodik ndihmon në zgjatjen e jetëgjatësisë së pajisjes.

Pas çdo cikli, mbajeni derën dhe folenë e detergjentit paksa të hapur që të ketë qarkullim të ajrit dhe që të thani lagështirën brenda pajisjes: kjo do të parandalojë mykun dhe aromat e këqija.

Nëse pajisja nuk do të përdoret për një kohë të gjatë: mbyllni rubinetin e ujit dhe shkëputni pajisjen nga rrjeti elektrik.

Programi tregues i pastrimit periodik:

Heqja e çmërsit	Dy herë në vit
Larja e mirëmbajtjes	Një herë në muaj
Pastrimi i guarnicionit të kapakut	Çdo dy muaj
Pastrimi i kazanit	Çdo dy muaj
Pastrimi i folesë së detergjentit	Çdo dy muaj
Pastrimi i filtrit të pompës së shkarkimit	Dy herë në vit
Pastrimi i tubit të hyrjes së ujit dhe filtrit të valvulës	Dy herë në vit

Paragrafët e mëposhtëm shpjegojnë se si duhet ta pastroni secilën pjesë.

13.2 Heqja e objekteve të huaja



Sigurohuni që xhepat të jenë bosh dhe të gjitha elementet e lira të jenë lidhur përpara se të vini në punë ciklin. Referohuni tek "Ngarkesa e rrobave" te "Udhëzime dhe këshilla".

Hiqni çdo objekt të huaj (si p.sh. kapëse metalike, kopsa, monedha etj.) që mund të gjeni në filtra dhe kazan. Referohuni tek paragrafët "Pastrimi i kazanit", "Pastrimi i pompës së shkarkimit" dhe "Pastrimi i tubit të hyrjes së ujit dhe filtrit të valvulës". Nëse është e nevojshme, kontaktoni me Qendrën e Autorizuar të Shërbimit.

13.3 Pastrimi i jashtëm

Pastrojeni pajisjen vetëm me ujë të ngrohtë dhe sapun të butë. Thajini plotësisht të gjitha sipërfaqet. Mos përdorni shtupa kruajtëse ose materiale të tjera gërvishtëse.



KUJDES!

Mos përdorni alkool, tretës boje ose produkte kimike.



KUJDES!

Mos pastroni sipërfaqet metalike me detergjent me bazë klori.

13.4 Heqja e çmërsit



Nëse fortësia e ujit në zonën tuaj është e lartë ose mesatare, rekomandojmë që të përdorni produkt zbutjeje uji për lavatriçe.

Kontrollojeni kazanin rregullisht për të kontrolluar për çmërs.

Detergjentet standarde përmbajnë agentë për zbutjen e ujit, por rekomandojmë që herë pas here të vini në punë një cikël me kazan bosh dhe një produkt kundër çmërsit.



Zbatoni gjithmonë udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produktit.


13.5 Larja e mirëmbajtjes

Përdorimi i përsëritur dhe i zgjatur i programeve me temperaturë të ulët mund të shkaktojë depozitime të detergjenteve, mbetje pushi, rritje të bakteve brenda kazanit. Kjo mund të krijojë aroma të këqija dhe myk. Për të eliminuar depozitimet dhe për të pastruar pjesën e brendshme të pajisjes, aplikoni një larje mirëmbajtjeje rregullisht (të paktën një herë në muaj).



Referojuni paragrafit "Pastrimi i kazanit".

13.8 Pastrimi i sirtarit të detergjentit



13.9 Pastrimi i filtrit të shkarkimit

Kontrolloni rregullisht filtrin e pompës së shkarkimit dhe sigurohuni që të jetë e pastër.

Pastrojeni pompën e shkarkimit nëse:

- Pajisja nuk e shkarkon ujin.

13.6 Pastrimi i kazanit

Kontrollojeni kazanin rregullisht për të parandaluar formimin e ndryshkut.

Pastroni kazanin me produkte të posaçme për inoks.



Zbatoni gjithmonë udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produktit.

Për pastrim të plotë:

- Nxirni të gjitha rrobat nga kazani.
- Vini në punë një program Cottons me temperaturën më të lartë. Shtoni një sasi të vogël detergjenti pluhur në kazanin bosh për të shpëlarë mbetjet e mundshme.

13.7 Izolimi i kapakut

Kontrolloni rregullisht guarnicionin dhe hiqni të gjitha objektet nga pjesa e brendshme. Pastrojeni kur nevojitet, duke përdorur agent pastrues me krem amoniaku pa gërvishur sipërfaqen e izolimit.



Zbatoni gjithmonë udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produktit.

- Kazani nuk rrotullohet.
- Pajisja bën një zhurmë të pazakontë për shkak të bllokimit të pompës së shkarkimit.
- Në ekran shfaqet kodi i alarmit **E20**




PARALAJMËRIM!


- Shkëputni spinën nga priza elektrike.
- Mos e hiqni filtrin gjatë kohës që pajisja është në punë.
- Mos e pastroni pompën nëse uji në pajisje është i nxehtë. Prisni derisa uji të ftohet.

Mbani gjithmonë një leckë pranë për të fshirë çdo rrjedhje uji gjatë heqjes së filtrit.

Vazhdoni si më poshtë për të pastruar pompën:



13.10 Pastrimi i tubit të hyrjes së ujit dhe filtrit të valvulës



13.11 Shkarkimi i emergjencës

Nëse pajisja nuk mund ta shkarkojë ujin, kryeni të njëjtën procedurë që

përkruhet në paragrafin "Pastrimi i pompës së shkarkimit". Nëse është e nevojshme, pastroni pompën.

Kur e shkarkoni ujin me procedurën e shkarkimit të emergjencës, ju duhet ta aktivizoni përsëri sistemin e shkarkimit:

1. Hidhni 2 litra ujë në folenë e larjes kryesore të folesë së detergjentit.
2. Nisni programin për të shkarkuar ujin.

13.12 Masat paraprake të parandalimit të brymës

Nëse pajisja është e instaluar në një zonë ku temperatura mund të arrijë vlera rreth 0° C ose të bjerë më poshtë, hiqni ujin e mbetur nga tubi i hyrjes së ujit dhe pompa e shkarkimit.

1. Hiqni spinën nga priza elektrike.
2. Mbyllni rubinetin e ujit.
3. Vendosni dy skajet e tubit të hyrjes së ujit në një enë dhe lëreni ujin të rrjedhë nga tubi.

4. Zbrazni pompën e shkarkimit. Referojuni procedurës së shkarkimit të emergjencës.
5. Kur pompa e shkarkimit të jetë e zbrazur, vendosni përsëri tubin e hyrjes së ujit.



PARALAJMËRIM!

Sigurohuni që temperatura të jetë më e lartë se 0 °C përpara se ta përdorni sërish pajisjen. Prodhuesi nuk mban përgjegjësi për dëme të shkaktuara nga temperaturat e ulëta.

14. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE



PARALAJMËRIM!

Referojuni kapitujve për sigurinë.

14.1 Kodet e alarmit dhe defektet e mundshme

Pajisja nuk ndizet ose ndalon gjatë punës. Së pari, përpikuni të gjeni një zgjidhje për problemin (shikoni tabelat).



PARALAJMËRIM!

Çaktivizojeni pajisjen përpara se të kryeni ndonjë kontroll.

Për disa probleme, ekrani tregon kodin e alarmit dhe butoni

Start/Pause  mund të pulsojë në mënyrë të vazhdueshme:

Problemi	Zgjidhja e mundshme
E 10 Pajisja nuk mbushet mirë me ujë.	• Sigurohuni që rubineti i ujit të jetë i hapur. • Sigurohuni që presioni i furnizimit me ujë të mos jetë shumë i ulët. Për këtë informacion, kontaktoni autoritetet vendase të ujësjellësit. • Sigurohuni që rubineti i ujit të mos jetë i bllokuar. • Sigurohuni që zorra e furnizimit me ujë të mos jetë e përdredhur, e dëmtuar ose e përthyer. • Sigurohuni që lidhja e zorrës së hyrjes së ujit të jetë e saktë. • Sigurohuni që filtri në zorrën hyrëse dhe filtri i valvulës të mos jenë të bllokuar. Shikoni kapitullin "Kujdesi dhe pastrimi".

E20 Pajisja nuk e shkarkon ujin.	• Sigurohuni që tubi lidhës i lavamanit të mos jetë i bllokuar. • Sigurohuni që zorra e shkarkimit të mos jetë e përdredhur ose e përrthyer. • Sigurohuni që filtri i shkarkimit të mos jetë i bllokuar. Nëse është e nevojshme, pastrojeni filtrin. Shikoni kapitullin “Kujdesi dhe pastrimi”. • Sigurohuni që lidhja e zorrës së shkarkimit të jetë e saktë. • Vendosni programin e shkarkimit nëse vendosni programin pa fazën e shkarkimit. • Vendosni programin e shkarkimit nëse vendosni një opsion që përfundon me ujë në kazan.
E91 Avari e brendshme. Nuk ka komunikim ndërmjet elementëve elektronikë të pajisjes.	• Programi nuk ka përfunduar siç duhet ose pajisja ka ndaluar shumë herët. Fikeni dhe rindizeni pajisjen. • Nëse shfaqet sërish kodi i alarmit, kontaktoni qendrën e autorizuar të shërbimit.
EKO Furnizimi me rrymë është i paqëndrueshëm.	• Prisni derisa furnizimi me rrymë të bëhet i qëndrueshëm.

Nëse ekrani shfaq kode të tjera alarmi, çaktivizoni dhe aktivizoni pajisjen. Nëse problemi vazhdon, lidhuni me qendrën e autorizuar të shërbimit.

Në rast problemi të ndryshëm me lavatriçen, kontrolloni tabelën e mëposhtme për zgjidhjet e mundshme.

Problemi	Zgjidhja e mundshme
Programi nuk fillon.	• Sigurohuni që spina të jetë futur në prizë. • Sigurohuni që kapaku i pajisjes dhe dera e kazanit të jenë mbyllur. • Sigurohuni që kutia e siguresave të mos ketë ndonjë siguresë të prishur. • Sigurohuni që Start/Pause  të jetë prekur. • Nëse caktohet vonesa në nisje e programit, anuloheni cilësimin ose prisni sa të përfundojë numërimi mbrapsht. • Çaktivizoni funksionin e bllokimit për fëmijët, nëse është i ndezur. • Kontrolloni pozicionin e çelësit në programin e përzgjedhur.
Pajisja mbushet me ujë dhe e shkarkon atë menjëherë.	• Sigurohuni që zorra e shkarkimit të jetë në pozicionin e duhur. Zorra mund të jetë pozicionuar shumë poshtë. Shihni kapitullin “Udhëzime instalimi”.

Problemi	Zgjidhja e mundshme
Faza e centrifugimit nuk funksionon ose cikli i larjes zgjat më shumë se zakonisht.	- Vendosni programin e centrifugimit. - Sigurohuni që filtri i shkarkimit të mos jetë i bllokuar. Nëse është e nevojshme, pastrojeni filtrin. Shikoni kapitullin "Kujdesi dhe pastrimi". - Rregulloni me dorë artikujt brenda kazanit dhe niseni sërish fazën e centrifugimit. Ky problem mund të shkaktohet nga probleme ekuilibri.
Ka rrjedhur ujë në dysHEME.	- Sigurohuni që bashkueset e zorrëve të ujit të jenë shtyrë fort dhe që nuk ka rrjedhje uji. - Sigurohuni që zorra e hyrjes së ujit dhe zorra e shkarkimit të mos kenë dëmtime. - Sigurohuni që të përdorni detergjentin e duhur dhe sasinë e duhur të tij.
Kapaku i pajisjes nuk mund të hapet.	- Sigurohuni që të mos jetë zgjedhur një program larjeje që përfundon me ujë në kazan. - Sigurohuni që programi i larjes ka përfunduar. - Vendosni programin e shkarkimit ose të centrifugimit nëse ka ende ujë në kazan. - Sigurohuni që pajisja furnizohet me energji. - Ky problem mund të shkaktohet nga një defekt i pajisjes. Kontaktoni qendrën e autorizuar të shërbimit.
Pajisja bën një zhurmë të pazakontë dhe dridhet.	- Sigurohuni që nivelimi i pajisjes është i saktë. Shihni kapitullin "Udhëzime instalimi". - Sigurohuni që të kenë hequr paketimin dhe/ose bulonat e transportit. Shihni kapitullin "Udhëzime instalimi". - Shtoni më shumë rroba në kazan. Ngarkesa mund të jetë tepër e vogël.
Kohëzgjatja e programit ngrihet ose ulet gjatë punës së programit.	SensiCare System është në gjendje të përshtatë kohëzgjatjen e programit sipas llojit dhe sasisë së rrobave. Shikoni paragrafin "Dallimi i ngarkesës me SensiCare System" në kapitullin "Përdorimi i përditshëm".
Rezultatet e larjes nuk janë të kënaqshme.	- Shtoni sasinë e detergjentit ose përdorni një lloj tjetër. - Përdorni produkte të veçanta për të hequr njollat e vështira përpara se të lani rrobat. - Sigurohuni që të vendosni temperaturën e duhur. - Pakësoni ngarkesën e rrobave.
Ka shumë shkumë në kazan gjatë ciklit të larjes.	Reduktoni sasinë e detergjentit.

Pas kontrollit, aktivizojeni pajisjen. Programi vazhdon nga pika e ndërprerjes.

Nëse problemi ndodh përsëri, lidhuni me qendrën e autorizuar të shërbimit.

Të dhënat e nevojshme për qendrën e shërbimit ndodhen në etiketën e parametrave.

15. VLERAT E KONSUMIT

15.1 Hyrje



Shikoni lidhjen **www.theenergylabel.eu** për informacion të detajuar rreth etiketës së energjisë.



Kodi QR në etiketën e energjisë të dhënë me pajisjen jep një lidhje interneti tek informacioni që lidhet me performancën e pajisjes në databazën e EU EPREL. Ruajeni etiketën e energjisë për referencë së bashku me manualin e përdorimit dhe të gjitha dokumentet e tjera që ofrohen me këtë pajisje.
Të njëjtin informacion mund ta gjeni gjithashtu në EPREL duke përdorur lidhjen **<https://eprel.ec.europa.eu>**, emrin e modelit dhe numrin e produktit që gjeni në pllakëzën e specifikimeve të pajisjes. Shikoni kapitullin “Përshkrim i produktit” për pozicionin e pllakëzës së specifikimeve.

15.2 Legjenda

kg	Ngarkesa me rroba.	hh:m m	Kohëzgjatja e programit.
kWh	Konsumi i energjisë.	°C	Temperatura në rroba.
Litra	Konsumi i ujit.	rpm	Shpejtësia e centrifugimit.
%	Lagështira e mbetur në fund të fazës së centrifugimit. Sa më e lartë të jetë shpejtësia e centrifugimit, aq më e lartë është zhurma dhe aq më e ulët është lagështia e mbetur.		



Vlerat dhe kohëzgjatja e programit mund të variojnë në varësi të kushteve të ndryshme (p.sh. temperatura e dhomës, temperatura e ujit dhe presioni, madhësia e ngarkesës dhe lloji i rrobave, tensioni i furnizimit) dhe gjithashtu nëse ndryshoni cilësimin e parazgjedhur të një programi.

15.3 Sipas Rregullores së Komisionit të BE-së 2019/2023

Programi Eco 40-60	kg	kWh	Litra	hh:mm	%	°C	rpm ¹⁾
Ngarkesë e plotë	6	0.940	47.0	3:17	53.00	47	1151
Gjysmë ngarkese	3	0.518	37.0	2:35	53.00	39	1151

Programi Eco 40-60	kg	kWh	Litra	hh:mm	%	°C	rpm ¹⁾
Çerek ngarkese	1,5	0.260	29.0	2:35	55.00	25	1151

1) Shpejtësia maksimale e centrifugimit.

Konsumi i energjisë në regjime të ndryshme

Fikur (W)	Në gatishmëri (W)	Shtyrja e programit (W)
0.48	0.48	4.00
Koha deri në fikje/Regjimi në pritje është maksimumi 15 minuta.		

15.4 Programet e zakonshme



Këto vlera janë vetëm për qëllim informativ.

Programi	kg	kWh	Litra	hh:mm	%	°C	rpm ¹⁾
Cottons ²⁾ 90°C	6	2.60	85.0	3:25	53.00	85	1200
Cottons 60°C	6	1.85	85.0	3:25	53.00	55	1200
Cottons 20° ³⁾ 20°C	6	0.40	85.0	2:45	53.00	20	1200
Synthetics 40°C	3	0.65	55.0	2:10	35.00	40	1200
Delicates ⁴⁾ 30°C	2	0.35	50.0	1:00	35.00	30	1200
Wool 30°C	1	0.20	35.0	1:10	30.00	30	1200

1) Treguesi i referencës së shpejtësisë së centrifugimit.


2) E përshtatshme vetëm për larjen e tekstileve me ndotje të madhe.

3) I përshtatshëm për të larë rroba të pambukta, sintetike dhe të përziera me pak ndotje.

4) Gjithashtu vepron si cikël i larjes së shpejtë për rrobat e ndotura pak.

16. UDHËZUES I SHPEJTË

16.1 Përdorimi i përditshëm



Futeni në prizë spinën e pajisjes.

Hapeni rubinetin e ujit.

Futni rrobat në pajisje.

Derdhni detergjentin dhe çdo trajtim tjetër në ndarjen përkatëse të folesë së detergjentit.


1. Shtypni butonin **Ndezje/Fikje** për të aktivizuar pajisjen. Rrotulloni çelësin e programeve për të vendosur programin e dëshiruar.

2. Vendosni opsionet e dëshiruara (1) përmes butonave korrespondues me prekje. Për të nisur programin, prekni butonin **Start/Pause** (2).

3. Pajisja fillon punën. Në përfundim të programit, hiqni rrobat.

Shtypni butonin **Ndezje/Fikje** për të fikur pajisjen.

16.2 Pastrimi i filtrit të pompës së shkarkimit



Pastrojeni filtrin rregullisht dhe, veçanërisht, nëse shfaqet kodi **E20** në ekran.

16.3 Programet

Programet	Ngarkesa	Përshkrimi i produktit
Eco 40-60	6 kg	Të pambuktat e bardha dhe ato me ngjyra. Rrobat me ndotje normale.
Cottons	6 kg	Të pambuktat e bardha dhe me ngjyra.
Synthetics	3 kg	Artikuj sintetikë ose tekstile të përziera.

Programet	Ngarkesa	Përshkrimi i produktit
Delicates	2 kg	Tekstile delikate të tilla si akrilike, viskoze, poliestër.
Rapid 14min	1,5 kg	Artikujt e pambuktë dhe sintetikë me pak ndotje ose të veshura një herë.
Rinse	6 kg	Të gjitha tekstilet, përveç të leshtave dhe tekstileve shumë delikate. Program për të shpëlarë dhe për të centrifuguar.
Spin/Drain	6 kg	Të gjitha tekstilet, përveç të leshtave dhe tekstileve shumë delikate. Program për të centrifuguar dhe për të shkarkuar ujin.
 Anti-allergy	6 kg	Artikuj të bardhë të pambuktë. Ky program ndihmon në heqjen e mikrobeve dhe baktereve.
Baby	2 kg	Cikël delikat i përshtatshëm për rrobat e bebeve.
 Silk	0,5 kg	Program special për rroba mëndafshi dhe sintetike të përziera.
 Wool	1 kg	Të leshta që lahen me lavatriçe, të leshta që lahen me dorë dhe tekstile delikate.
Sport	3 kg	Veshje sportive.
 Outdoor	2 kg ¹⁾ 1 kg ²⁾	Rroba sportive moderne që vishen jashtë.
Denim	2 kg	Rrobat prej doku.

1) Programi i larjes.

2) Programi i larjes dhe faza e kthimit të papërshkueshmërisë nga uji.

17. ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AMBIENTIN

Ricikloni materialet me simbolin . Vendoseni ambalazhin te kontejnerët e riciklimit nëse ka. Ndiemoni në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve dhe në riciklimin e mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike. Mos hidhni

pajisjet e shënuara me simbolin  e mbeturinave shtëpiake. Ktheni produktin në pikën lokale të riciklimit ose kontaktoni me zyrën komunale.

www.electrolux.com/shop



135968940-A-082023

